



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:115593

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05756012

CN.2024:115594

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri, në çështjen jo kontestimore të propozuesit – kundërshtarit të sigurimit ‘...’ me seli në, me pronar N. E. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av.Fahredin Ymeri nga Gjilani, i ushtruar propozuesit të masës së sigurisë H.R. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av.Fitim Klinaku nga Prishtina, duke vendosur mbi propozimin për anulimin e masës së sigurisë, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 24 maj 2024 në prezencë të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, me datë 30 maj 2024 ka marr këtë;

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET propozimi i paraqitur nga propozuesi- kundërshtari i sigurimit ‘...’, i ushtruar kundërpropozuesit- propozuesit të sigurimit H. R., për anulimin e masës së sigurisë.
- II. ANULOHET MASA E SIGURISË e caktuar me AKTVENDIMIN e kësaj Gjykate të evidentuar me CN.nr.109/13 e datës 28.03.2013, me të cilin i ishte NDALUAR të paditurit të bëjë shitjen e e paluajtshmërive- lokaleve afariste dhe banesave të ndërtuara në Ferizaj, në ngastrën kadastrale dhe, të vendi i quajtur ‘...’- objekti te ‘...’, deri në përfundimin e procedurës kontestimore me vendim të formës së prerë, sipas padisë së paditësit.

A r s y e t i m

Propozuesi i sigurimit H.R. pranë kësaj gjykate me datë 15.08.2012 kishte paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, kundër kundërshtarit të sigurimit ... ‘...’ me seli në.....

Gjykata me datë 28.03.2013 me Aktvendim ka aprovuar propozimin e propozuesit H. R...kishte aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën i kishte ndaluar kundërpropozuesit ... ‘’...’’, deri në zgjidhjen e çështjes sipas padisë.

Gjykata e shkallës së parë sa i përketë padisë së paditësit me Aktgjykimin e datës 01.03.2019 me numër C.nr..... kishte vendosur lidhur me padinë e paditësit H.R. kundër të paditurës ...’’...’’ ..., me pronar N. E., kundër këtij Aktgjykimi palë kishin ushtruar ankesë dhe në bazë të Aktvendimit me numër Ac.nr. të datës 18.10.2023, këtë çështje e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Me datë 19.04.2024 kundërshtari i sigurimit.... ‘’....’’ ka paraqitur propozim për anulimin e masës së përkohshme të sigurisë, gjykata pas pranimit të këtij propozimi, ka nxjerr lëndën nga Arkiva dhe ka mbajtur seancën dëgjimore në këtë çështje.

I autorizuari i kundërshtarit të sigurimit në seancën dëgjimore dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruar sidomos kontratës me te cilën është marr ky aktvendim i masës ku vërtetohet se N. E.nuk ka qene nënshkruer i kësaj kontrate dhe si përfundim kjo marrëveshje nuk mund te merret si baze për aktvendimin me te cilin është vendosur masa e sigurisë, gjithashtu edhe marrëveshja tjetër e cila merret si baze për këtë aktvendim i datës 23.09.2012 nuk mund te jete si baze kur kundër propozuesi nëpërmjet dëshmitarit N.R.ka njoftuar se heke dore nga kjo marrëveshje. Kur kemi këto prova te cilat nuk munde te shërbejnë si baze ne një aktvendim te tillë atëherë edhe vendimi i caktimi te masës se sigurisë nuk mund te jete ne fuqi. Sa i përket kërkesë se përfaqësuesit kundër propozuesit se masa e sigurisë është caktuar pasi qe është bere besueshëm ekzistimi i kërkesë për caktimin e saj mendoj se një kërkesë e tille nuk munde te jete edhe at het edhe tani si baze dhe te merret si besueshme një kërkesë e tillë, por duke marrur parasysh aktvendimin e mase se sigurisë duhet një vendim i tillë te jete i kjart dhe te dihet çka ndalohet me ata mase se sigurisë ne atë aktvendim përfshihen edhe lokalet edhe banesat qe edhe ne ate kohe kane qene te shitura te cilat nuk janë identifikuar fare kështu qe mendojmë një vendimi i tillë me një diapozitiv te tillë nuk mund te jete i besueshme për te ekzistuar si i tillë. Për një vendim te tillë duhet te jete shkak se cili lokal apo banës duhet te ndalohet tani propozuesit qe te tani te disponon me to, edhe një propozimi i tillë për një mase te tillë ne bazë te nenit 297 te LPK-se ku ceket s ekziston rreziku për caktimin e saj dhe se një propozim i tillë është bere i besueshëm përfaqësuesi i kundër propozues nuk e cek faktin me rendësi se një propozim i tillë merret parasysh nen kushtet e propozuesi te masës se sigurisë

brenda afatit te caktuar nga gjykata ashtu qe siç parashihet me LP te jep garanci mbi masën dhe llojin e caktuara nga gjykata për demin qe mund ti shkaktohet palës kundërshtare me caktimin edhe ekzekutimin e masës se sigurisë, ndërsa me neni 297 pika 3 është parapara qe po qe propozuesi nuk jep garanci brenda afatit te caktuar gjykata e refuzon propozimin për caktimin e masës se sigurisë . Kjo e vërteton faktin se propozuesi nuk ka dhen garancinë dhe gjykata vetëm me propozimin e ushtruar te jep një mase te tillë te themi se është jo ligjore. Ne te njëjtën procedure paraprakisht është refuzuar propozimi i propozuesit H.R.për caktimin e masës se përkohshme te sigurisë me aktvendim N.dr325/12 datës 09.10.2012, besoj qe vete ekzistimi i këtyre provave dhe vendimi i marr e bene një propozim qe kjo mase duhet te anulohet.

I autorizuari i propozuesit të sigurimit në seancën dëgjimor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se është e domosdoshme te ketë një vendim me ane te se cilit caktohet një mase e sigurisë ngase pa ketë vendim i mbrojturi ime ne asnjë mënyrë nuk do te mund qe te realizoj te drejtën e tij ne atë qe po lufton për me shumë se 10 vite. Lidhur me atakimin e kontratave te datës 15.08.2007 dhe 23.09.2012 ky atakim do te duhej te behet komfor dispozitave te LMD-se ku propozuesi ka pasuar afat një vite ne baze te nenit 102 para.1 qe te zhvilloj procedurën mbi anulimin e kontratave , ne sot nuk kemi asnjë propozim asnjë vendim te prezantuar ne ketë seancë te bere brenda afat ligjore te caktuar nga LMD-ja për anulimin këtyre kontratave.

Ne funde është e domosdoshme qe te jete ekzistente masa e sigurimit me te cilin do te ndalonte te gjitha shitjet ne komplekset afaristë banesore tek dhe pasi qe pretendimet e te njëjti janë vërtetimi i pronësisë 50/50 e jo një lokal dhe një banës .

Për ti dhënë zgjidhje meritorë këtij procesit eshë e domosdoshme një mase e tillë e cila do ti kontribuon palëve ndërgjyqëse ne ketë procedure .

Gjykata në këtë seancë të dëgjimit ka bërë, administrimin e provave dhe atë Aktvendimin me numër i datës 20.12.2012 dhe propozimi për anulimin e masës se sigurisë i datës 18.03.2024.

Pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i kundërshtarit të sigurimit për anulimin e masës së sigurisë është i bazuar.

Gjykata vlerëson se masa e sigurisë e vendosur me datë CN.nr.... e datës 28.03.2013, pavarësisht faktit që padia e paditësit për vërtetim pronësie dhe kompensim dëmi e evidentuar me numër ... është në shqyrtim e sipër, për gjykatën kjo masë e caktuar nuk prodhon efekt juridik dhe e njëjta

duhet të anulohet, për faktin se provat mbi të cilat ka rezultuar si e bazuar kërkesa për caktimin e masës së sigurisë, dhe atë prova materiale Marrëveshja e datës 15.08.2007, vetë propozuesi i masës së sigurimit në çështjen e iniciuar sipas padisë në një nga seancat e mbajtura dhe atë në procesverbalin e datës 02.07.2013, i autorizuari i tij kishte deklaruar se *‘...marrëveshja e cila është kontestuese e datës 15.08.2007 kemi ardhur në njohuri se është e nënshkruar nga bashkëpronari më i afërt i të paditurit A. E., të cilin i padituri e ka nip..’*. Andaj duke u nisur nga ky fakt, rezulton se vetë propozuesi i masës së sigurisë, e ka bërë të pabazuar dhe të paqëndrueshëm propozimin për masë të sigurisë.

Gjykata ka konstatuar se, masa e sigurisë si e tillë nuk prodhon më efekt juridik dhe qëllimi mbi të cilën është caktuar ka pushuar në momentin që pala propozuese ka pranuar faktin se marrëveshja si e tillë nuk është nënshkruar nga kundërshtari i sigurimit, gjykata duke u gjetur në këto rrethana, vendosi që ta anuloj masën e përkohshme të sigurimit të caktuar sipas aktvendimit të kësaj gjykate të evidentuar me CN.nr.109/13 e datës 28.03.2013.

Nga sa u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 306 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL

C.2024:11594, me datë 30 maj 2024

Gjyqtarja
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.